

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT
PRISHTINË



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Pranuar me: 22.05.2025			
Nj. org.	Numër	Shtojca	Vlera
06	1018/1	-	-



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora Inxhinjere Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
Mjësia org. Org. Jedmeka Org. Unit	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.
Mr. i faqes Br. Stranica Nr. Pages	Data: Datum: Date:
012K	176/2025
/	22.05.2025
PRISHTINË / A	No.1

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I LIDHUR NDËRMJET

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT, UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Në përputhje me: Ligjin Nr. 08/L-012 "Për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit"(OIRK); Statutin dhe aktet e brendshme të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës; Statutin Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti i Prishtinës, FIN,UP duke u bazuar në parimin e bashkëpunimit institucional mbështetur edhe në interesat e përbashkëta mes OIRK dhe FIN që kanë për qëllim avancimin dhe ngritjen profesionale në arsimin e lartë, bashkëpunimit shkencor, arsimor dhe akademik në mes të dy institucioneve, avansimin e profesionit të inxhinierisë ndërtimore, dhe hapja e mundësive të reja për bashkëpunim për studentët, stafin akademik dhe administrative, e lidhin këtë:

Memorandum bashkëpunimi

Palët pjesëmarrëse:

Ky Memorandum bashkëpunimi lidhet me datën 22 maj 2025, ndërmjet:

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)
Adresa: Kompleksi Rilindja, Kontejneri nr. 3, Kati 2, 10000 Prishtinë.

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti i Prishtinës,
Adresa: Rr. Agim Ramadani, objekti i "Fakulteteve Teknike", 10000 Prishtinë, Kosovë

Neni 1

Qëllimi i Memorandumi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është vendosja e kornizës së bashkëpunimit ndërinstitutional për qëllime akademike, profesionale në fushat e Inxhinierisë dhe disiplinave tjera të lidhura me Inxhinierinë.

Promovimi i vlerave profesionale, etike dhe teknike në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 2

Objektivat

Ky bashkëpunim synon:

- ngritjen e cilësisë në edukim në fushën e inxhinierisë së ndërtimit;
- forcimin e lidhjes në mes të komponentës akademike dhe profesionale;
- mbështetjen e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të studentëve, studentëve të sapo diplomuar, praktikantëve dhe inxhinierëve të licencuar;
- krijimin dhe mbështetjen e realizimit të projekteve shkencore dhe të nevojave profesionale që lidhen me zhvillime në fushat e Inxhinierisë së Ndërtimit.

- organizimin e trajnimeve; punëtorive, konferencave dhe aktivitete tjera të përbashkëta.
- zhvillimi i iniciativave të përbashkëta në interes të të dyja palëve.

Neni 2

Fushat e Bashkëpunimit

Palët pajtohen të bashkëpunojnë në këto fusha:

- 2.1 Aktivitete akademike dhe profesionale të përbashkëta** – përfshirë ligjërata e hapura, seminare, punëtori dhe trajnime me pjesëmarrjen e stafit akademik dhe ekspertëve profesionalë nga të dy institucionet;
- 2.2 Edukimi i vazhdueshëm profesional** – përkrahje të ndërsjellë për organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve për edukim të vazhdueshëm profesional për studentët, studentët e sapo diplomuar, praktikantët dhe inxhinierët e licencuar;
- 2.3 Shfrytëzimi i hapësirave të Fakultetit** – OIRK dhe FIN për realizimin e aktiviteteve promocionale, për trajnime për edukim të vazhdueshëm dhe ngjarjeve të veçanta me marrëveshje paraprake rregullojnë shfrytëzimin e hapësirave;
- 2.4 Zhvillimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i praktikës profesionale për studentët e sapo diplomuar**– mbështetja profesionale përmes individëve dhe subjekteve anëtar të OIRK dhe FIN lidhur me zhvillimin e praktikave profesionale për studentët e sapo diplomuar;
- 2.5 Kontribut në zhvillimin e kurrikulave akademike** – sipas ftesës së IAL-së përfshirje e OIRK në proceset e rishikimit të kurrikulave dhe standardeve akademike, me synim përputhshmërinë me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet teknike bashkëkohore;
- 2.6 Mbështetje për hulumtime dhe projekte të përbashkëta shkencore** – përfshirë publikime, aplikime në fonde kërkimore dhe pjesëmarrje në konferenca e ngjarje shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- 2.7 Angazhimi i studentëve dhe studentëve të sapo diplomuar në administratën e OIRK** – Fakulteti do të përkrahë identifikimin dhe përzgjedhjen e studentëve për angazhim në punë praktike apo vullnetare në administratën e Odës, me qëllim ofrimin e përvojës praktike institucionale, ngritjen e aftësive profesionale dhe afrimin e tyre me realitetin e tregut të punës.

Neni 3

Koordinimi dhe Zbatimi

Palët do të caktojnë nga një koordinator të autorizuar, të cilët do të jenë përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Koordinatorët do të koordinojnë aktivitetet e përbashkëta, do të përcjellin zbatimin dhe do të raportojnë rregullisht tek palët përkatëse.

Neni 4

Bashkëpunimi në përkrahjen profesionale dhe zhvillimet ligjore në fushën e ndërtimit

4.1. Palët pajtohen që, sipas nevojës dhe kapaciteteve të tyre, të ofrojnë përkrahje të ndërsjellë në çështje që lidhen me zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit, rregulloreve dhe standardeve profesionale në fushën e ndërtimit.

4.2 Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit do të kontribuojë me ekspertizën e stafit akademik në proceset e shqyrtimit profesional, analizës së implikimeve teknike të propozimeve ligjore dhe përgatitjes së opinionit akademik në fushat përkatëse, sipas dakordimeve paraprahe në mes të OIRK dhe FIN.

4.3 OIRK do të mbështesë Fakultetin në adresimin e sfidave, praktikave që lidhen me harmonizimin e mësimdhënies dhe kërkesave të dala nga tregu.

Ky bashkëpunim synon të ndihmojë në:

- përmirësimin e kuadrit ligjor dhe profesional të fushave të ndërtimit në Kosovë;
- fuqizimin e rolit të institucioneve akademike në proceset vendimmarrëse në fushën e inxhinierisë;
- ngritjen e standardeve teknike e etike në ushtrimin e profesionit.

Neni 5

Kohëzgjatja e Memorandumit të Bashkëpunimit

Ky memorandum bashkëpunimi shpreh vullnetin e lirë të palëve për bashkëpunim ndër-institucional.

Afati kohor i vlefshmërisë së kësaj marrëveshje është detyrues për të dyja palët (nënshkruese të kësaj marrëveshje) për një periudhë tre (3) vjeçare nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

Neni 6

Kopjet dhe Gjuha e Memorandumit të Bashkëpunimit

Ky Memorandum i bashkëpunimit është hartuar në dy kopje origjinale, që përmban tekstin në gjuhën shqipe. Secila palë do të ketë nga një kopje të origjinalit të nënshkruar.

Neni 7

Amandamentimi i memorandumit

Gjatë zbatimit të këtij Memorandumi, në rast se palët arrijnë në konstatime se nevojitet plotësimi, ndryshimi apo amandamentimi i memorandumit, atëherë një gjë e tillë do të bëhet në formë të shkruar dhe do të konsiderohet si aneks i veçantë i këtij memorandum.

Neni 8

Zgjidhja dhe përfundimi i Memorandumi

Në çdo rast të mosmarrëveshjeve, interpretimeve apo pikëpamjeve të ndryshme ndërmjet palëve, do të zhvillohen përpjekjet për arritjen e pajtimit të ndërsjellë, përmes bisedimeve.

Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi i memorandumit duhet ti paraprijë njoftimi me shkrim, 30 ditë përpara, nga pala tjetër duke treguar arsyet e përfundimit të bashkëpunimit.

Neni 9

Dispozita Përfundimtare

Çdo çështje që nuk është e rregulluar shprehimisht me këtë Memorandum Bashkëpunimi do të trajtohet në frymën e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë. Memorandum do të zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet themeltare të të dy institucioneve.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët

PALËT NËNSHKRUESE

Ind.Dpl. Arsim Rapuca

Kryetar i Odës së Inxhinierëve
të Republikës së Kosovës



Prof.asst.Dr.Florim Grajçevci

Dekan
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit



Prishtinë,
Data 22 maj 2025